



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**BURSA STUDIMI BACHELOR/ MASTER / DOKTORATURË
NË REPUBLIKËN ÇEKE
VITI AKADEMIK 2018-2019**

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillimin, Qeveria e Republikës së Çekisë ofron për studentë shqiptarë 3 (tre) bursa të plota për studime doktorate/Master (në gjuhën angleze) dhe një bursë për studime Bachelor/Master (në gjuhën çeke) për vitin akademik 2018-2019.

Bursat e studimit ofrohen në fushat e mëposhtme:

- Bujqësi dhe fusha të lidhura me të;
- Transport dhe fusha të lidhura me të;
- Studime mjedisore dhe fusha të lidhura me të;
- Ekonomik dhe fusha të lidhura me të;
- Specializime në fusha të teknologjisë/teknike.

Të gjithë kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të bëjnë regjistrimin dhe plotësimin e formularit të aplikimit *online* në adresën: <http://registr.dzs.cz/registr.nsf> deri më **datë 30 shtator 2017** që është edhe data e fundit për këtë aplikim.

Ky regjistër përmban informacion të detajuar për aplikantët e interesuar në gjuhën çeke dhe atë angleze.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE